


# **RISHIKIMI I DOTACIONEVE KOMUNALE: REFORMA E DOMOSDOSHME E DECENTRALIZIMIT FISKAL**

Tetor 2022



# Përmbajtja

<b>HYRJE</b>	<b>3</b>
<b>1. KONCEPTE</b>	<b>4</b>
Decentralizimit fiskal	4
Të ardhurat komunale	5
<b>2. ANALIZË E DOTACIONEVE TË TRANSFERUARA DREJT KOMUNAVE NË VITIN 2020</b>	<b>7</b>
2.1 Diskriminimi i parë: shpërndarja e padrejtë e dotacioneve në baza rajonale	7
2.2 Diskriminimi i dytë: shpërndarja e padrejtë e dotacioneve në baza kombëtare	9
2.3 Diskriminimi i tretë: shpërndarja e padrejtë politike	19
<b>KONKLUZION: DOMOSDOJA E RITJES SË AUTONOMISË FISKALE TË KOMUNAVE</b>	<b>21</b>

## HYRJJE

Ndërtimi i një sistemi demokratik që u përgjigjet kërkesave dhe pritshmërive të qytetarëve është i lidhur ngushtë me procesin e decentralizimit. Sa më i decentralizuar të jetë pushteti, aq më demokratik është vendi dhe aq më cilësore dhe efikase bëhen shërbimet publike që u ofrohen qytetarëve.

Mjerisht, për më shumë se dy dekada që nga fillimi i reformës së vetëqeverisjes lokale në Maqedoninë e Veriut, decentralizimi ngelet i mangët dhe një numër i madh i komunave janë të paafta që të përmbushin kompetencat e tyre për shkak të mungesës së hapësirës fiskale.

Modeli i decentralizimit fiskal ka krijuar varësi jashtëzakonisht të lartë të komunave nga buxheti qendror dhe dobësi të theksuar në gjenerimin e të ardhurave vetanake. Struktura e të ardhurave të vetëqeverisjes lokale vuan nga një disbalanc i theksuar në favor të dotacioneve të kapitalit. Një analizë nga “Finance Think” e buxheteve të 15 komunave më të mëdha në vend, konkludon se të ardhurat nga transferet dhe dotacionet nga pushteti qendror mesatarisht përbëjnë më shumë se dy të tretat e të ardhurave komunale<sup>1</sup>. Në komunat rurale dhe ato të vogla, proporcioni i transfereve dhe dotacioneve është edhe më i lartë.

Nga kjo, është e qartë se dotacionet nga niveli qendror kanë rëndësi jetike për financimin e vetëqeverisjes lokale si dhe përmbushjen e obligimeve kushtetuese të komunave. Veç kësaj ato janë edhe një mjet i fuqishëm për të ndikuar në pabarazitë financiare dhe zhvillimore midis komunave të vendit.

Ky model shpeshherë është denoncuar nga partitë opozitare dhe kryetarët e komunave për shkak të centralizmit ekstrem që ai përmbanë, por edhe për shkak të karakterit të supozuar shantazhues dhe diskriminues të sistemit të dotacioneve, varësisht nga gjeografia dhe përbërja kombëtare e komunave apo përkatësia politike e udhëheqjes komunale në aksin pushtet qendror – opozitë.

Në parim, pabarazitë ndërkomunale dhe rajonale do duhej të adresoheshin përmes nismës së 1% të PBV-së të alokuar për zhvillim të barabartë rajonal. Në praktikë, edhe përkundër rritjes së investimeve qendrore për zhvillim të barabartë rajonal gjatë viteve të fundit, arritja e cakut të 1% të PBV-së mbetet ende shumë larg pasi që detyrimi ligjor nuk zbatohet: vetëm 7,4 milion euro janë ndarë në buxhetin e vitit 2021, dhe rreth 7,8 milion euro janë planifikuar në buxhetin e vitit 2022, apo përafërsisht 0,05% e PBV-së.

<sup>1</sup> D. Petreska dhe B. Petreski, Zhvillim lokal ose shpenzime aktuale: Për çfarë qëllimi shpenzohen mjetet komunale?, Finance Think, 2013.

Për krahasim, të dhënat e Ministrisë së Financave tregojnë se dotacionet e transferuara drejt komunave në vitin 2020 kapin shumë më prej 302 milionë euro, apo mbi 2% e BPV-së. Pra, vlera totale e dotacioneve është mbi 40 herë më e lartë se ajo e fondeve të alokuara përmes nismës për zhvillim të barabartë rajonal.<sup>2</sup>

Andaj, dotacionet e pushtetit qendror drejt komunave meritojnë më tepër vëmendje në kuadër të reformës së mëtutjeshme të vetëqeverisjes lokale dhe debatit politik rreth decentralizimit fiskal.

## 1. KONCEPTE

Para se të thellohemi më tej në analizë rreth përmbajtjes dhe interpretimit të numrave të dotacioneve, është me rëndësi të sqarohet se çfarë është decentralizimi fiskal dhe si organizohen të ardhurat komunale.

### Decentralizimit fiskal

Decentralizimi fiskal është kusht themelor për vetëqeverisje lokale efektive dhe të aftë për të përmbushur obligimet e saj kushtetuese dhe ligjore. Në mënyrë që autoritetet lokale të kryejnë në mënyrë efektive përgjegjësitë e tyre të decentralizuara, ato duhet të kenë të ardhura adekuate; qoftë nga burimet e tyre vetanake ose përmes transfereve nga pushteti qendror.

Në këtë kontekst, decentralizimi fiskal i referohet procesit përmes së cilit pushteti qendror i transferon pushtetit lokal kompetenca të caktuara me anë të të cilave autoritetet lokale mund të marrin vendime për mbledhjen dhe shpenzimin e burimeve financiare brenda kompetencave të tyre. Për të pasur autonomi fiskale, autoriteteve lokale u nevojitet që pushteti lokal të ketë të drejtën për të vendosur dhe ndryshuar normat dhe bazat tatimore. Tani për tani, autoriteteve lokale kjo u mundësohet vetëm në shkallë të kufizuar.

Decentralizimi fiskal në Maqedoninë e Veriut është zbatuar në fazë, duke transferuar gradualisht kompetenca, sipas rritjes së kapacitetit të komunave për ndërmarrjen e këtyre përgjegjësisë. Të gjitha komunat, me përjashtim të Komunës së Pllasnicës,

---

<sup>2</sup> Ministria e Financave, Review of earmarked and block grants for delegated competences by municipality in 2020, [https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2021/01/04-Dotacii-po-opstini-Budzet-2020\\_EN.pdf](https://finance.gov.mk/wp-content/uploads/2021/01/04-Dotacii-po-opstini-Budzet-2020_EN.pdf).

kanë kaluar në fazën e dytë të decentralizimit fiskal, përkatësisht i kryejnë aktivitetet e menaxhimit dhe financimit të kompetencave të decentralizuara në kulturë, arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale dhe mbrojtje të fëmijëve.

## Të ardhurat komunale

Të ardhurat komunale u referohen të gjitha hyrjeve të mjeteve që një njësi e caktuar e vetëqeverisjes lokale i merr gjatë një viti buxhetor. Ligji për Financimin e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale<sup>3</sup> përcakton burimet e të hyrave vetanake të komunave:

- Tatimet lokale të përcaktuara me ligj: tatimi në pronë, në trashëgimi, në qarkullimin e patundshmërive dhe tatimet tjera lokale të përcaktuara me ligj.
- Taksat lokale të përcaktuara me ligj: taksat komunale, administrative dhe taksa të tjera lokale të përcaktuara me ligj.
- Shtesa (kompensime) të përcaktuara me ligj: kompensime për rregullimin e tokës ndërtimore, për veprimtari komunale, për plane hapësinore dhe urbanistike, si dhe kompensime të tjera lokale të përcaktuara me ligj.
- Të hyrat nga prona: të hyrat nga qiraja, nga kamatat dhe nga shitja e pronës.
- Të hyrat nga donacionet.
- Të hyrat nga gjobat në të holla.
- Të hyrat nga vetëkontributi.
- Të hyrat tjera të përcaktuara me ligj.

Ligji gjithashtu përcakton se nga buxheti qendror alokohen këto lloje të dotacioneve drejt komunave:

- **Të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH):** 4,5% e të ardhurave totale nga TVSH-ja të vitit fiskal paraprak duhet të ndahen midis komunave në raport me numrin e përgjithshëm të banorëve dhe në përputhje me kritere tjera të rregulluara me ligj. Këto financa kanë për synim barazimin fiskal të komunave.

<sup>3</sup> Ligji për financimin e njësive të vetadministrimit lokal ("Gazeta Zyrtare e RM", nr. 61/2004; 96/2004; 67/2007; 156/2009; 47/2011).

Secila komunë ka të drejtë të vendosë në mënyrë të pavarur se si do të shpenzohen këto para.

- **Dotacionet me dedikim** të cilat shpërndahen ndërmjet komunave, projekteve, institucioneve ose programeve të Ministrisë së Financave, me propozim të Ministrisë përkatëse, përmes një financimi të dedikuar për të mbështetur aktivitete konkrete.
- **Dotacionet kapitale** që ndahen për financimin e projekteve investive, në bazë të një programi të miratuar nga Qeveria. Komunitat duhet të hartojnë projekte, përfshirë ndarjen financiare të aktiviteteve të projekteve.
- **Blok dotacionet** që ndahen me qëllim të financimit të përgjegjësive të komunave në fushën e kulturës, sportit dhe rekreacionit, arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe shëndetësisë primare, sipas kriterëve për shpërndarjen e këtyre fondeve të përcaktuara në metodologjinë e Ministrisë përkatëse.
- **Dotacionet për kompetenca të deleguara** që mbështesin Kryetarin e komunës për kryerjen e përgjegjësive të deleguara nga një organ publik i administratës shtetërore.

## 2. ANALIZË E DOTACIONEVE TË TRANSFERUARA DREJT KOMUNAVE NË VITIN 2020

Përmbledhja e dotacioneve për vitin 2020 nga Ministrisë së Financave përfshinë dotacionet me dedikim dhe bllok dotacionet për kompetenca të deleguara drejt komunave në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm, kulturës, çerdheve, kujdesit për të moshuar dhe shërbimet zjarrfikëse.

**Shuma e përgjithshme e transfereve arrinë në mbi 18 miliardë denarë, apo mbi 302 milionë euro të transferuara drejt 80 komunave të vendit dhe Qytetit të Shkupit. 59% e kësaj shumë përbëhet nga bllok dotacionet në arsimin fillor, 27% në arsimin e mesëm dhe 11% në kujdesin parashkollor. Pjesa e ngelur prej 3% përbehet nga dotacionet me dedikim, të cilat shpërndahet midis shërbimeve zjarrfikëse, kujdesit për të moshuar, kulturës dhe arsimin fillor në komunën e Pllasincës.**

### 2.1 Diskriminimi i parë: shpërndarja e padrejtë e dotacioneve në baza rajonale

Fillimisht, është me rëndësi të analizohet se si shpërndahen dotacioneve ndërmjet rajoneve planore, të shprehura si investim për kokë banori, bazuar në rezultatet e regjistrimit të popullsisë 2021 (figura 1).

**Rajoni i Vardarit radhitet i pari me mesatarisht 188 euro dotacione për kokë banori, pasuar nga Lindori me 173 euro, Pellagonia me 150 euro, Verilindori me 137, Jugperëndimori me 135, Pollogu me 114 euro dhe Shkupi me 113 euro.**

Këtu duhet theksuar se Qyteti i Shkupit<sup>4</sup> përbën një nivel të mesëm të qeverisjes, me

<sup>4</sup> Qyteti i Shkupit ka status të veçantë juridik të përcaktuar me ligjin për Qytetin e Shkupit të miratuar në vitin 1996 (Ligji nr. 49/1996 dhe nr. 55/2004). Shkupi përbëhet nga dhjetë komuna autonome dhe ka më shumë se 526,000 banorë, që është rreth 25% e popullsisë së përgjithshme. Ligji për vetëqeverisje lokale specifikon se dispozitat e tij zbatohen për Qytetin e Shkupit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ligjin për Qytetin e Shkupit. Qyteti i Shkupit është përgjegjës për një gamë të gjerë politikash duke përfshirë planifikimin urban, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin ekonomik, kulturën, arsimin, sportin, mirëqenien sociale, mbrojtjen e fëmijëve, kujdesin shëndetësor dhe shërbimet zjarrfikëse. Ligji për Qytetin e Shkupit gjithashtu përcakton rregullat dhe procedurat për koordinim ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe dhjetë komunave dhe i obligon komunat dhe Qytetin e Shkupit të themelojnë një trup koordinues i cili takohet së paku një herë në muaj dhe i cili kryesohet nga Kryetari i

një buxhet vjetor prej rreth 155 milionë euro që plotëson buxhetet e 10 komunat që e përbëjnë atë, si dhe Produkt të Brendshëm Bruto (PBB) dukshëm më të lartë në nivel rajonal dhe prandaj edhe nevoja investive krejt të ndryshme nga komunat jashtë territorit të tij. Andaj Qyteti i Shkupit, për shkak të specifikave të tij, duhet lënë anash në kuadër të kësaj analize.

### **Ajo që bie në pah nga këto numra është një diskriminim i dyfishtë nga sistemi i dotacioneve, në baza zhvillimore dhe kombëtare:**

- **Lartësia e dotacioneve sipas rajoneve është thuajse në përpjesëtim të zhdrejtë me PBB-të rajonale**, apo ndryshe thënë, sa më i pasur rajoni, aq më të larta dotacionet, dhe anasjelltas, sa më i varfër rajoni aq më të ulëta dotacionet. Kështu, rajoni më i varfër, Pollogu me PBB prej 1.952 euro për kokë banori përfiton më së paku dotacione (114 euro për kokë banori), ndërsa rajoni më i pasur pas Shkupit, Vardari, me PBB prej 4.537 euro përfiton më së shumti dotacione (188 euro për kokë banor), apo mbi dyfish më shumë se Pollogu. Kësisoj, sistemi i dotacioneve thellon edhe më tej pabarazitë rajonale.
- Shkupin lënë anash, radhitja e rajoneve sipas investimeve për kokë banori dëshmon se **dotacionet janë gjithashtu në përpjesëtim të zhdrejtë me praninë e shqiptarëve brenda rajoneve**: sa më e ulët përqindja e shqiptarëve brenda një rajoni, aq më e lartë vlera e dotacioneve; sa më e lartë përqindja e shqiptarëve brenda një rajoni, aq më e ulët vlera e dotacioneve. Kësisoj, për shembull Pollogu i banuar kryesisht me shqiptarë pranon 40% më pak transfere nga dotacionet për kokë banori sesa Vardari i banuar kryesisht me maqedonë. E njëjta vlenë edhe për rajonet tjera ku jetojnë kryesisht shqiptarët.<sup>5</sup>

---

Shkupit. Qyteti i Shkupit dhe dhjetë komunat në territorin e tij bashkëpunojnë dhe ndajnë përgjegjësinë për të gjitha kompetencat që ushtron Qyteti i Shkupit.

<sup>5</sup> Në Rajonin e Vardarit, shqiptarët janë komuniteti i parë vetëm në Komunën e Çashkës, por ajo udhëhiqet nga partitë maqedone. Në Rajonin Lindor, nuk është asnjë komunë ku shqiptarët janë komuniteti i parë. Në Rajonin e Pellagonisë, shqiptarët janë komuniteti i parë vetëm në Komunën e Dollnenit, e cila udhëhiqet nga BDI. Në Rajonin Verilindor, shqiptarët janë shumicë vetëm në Komunën e Likovës, e cila udhëhiqet nga BDI. Në Rajonin Jugperëndimor, shqiptarët janë shumicë dhe udhëheqin me vetëm tre nga nëntë komuna sa ka rajoni: Dibra, Kërçova dhe Struga. Në Rajonin e Pollogut, shqiptarët janë shumicë në të gjitha komunat me përjashtim të Mavrovës dhe Rostushës dhe udhëheqin me gjashtë nga nëntë komuna sa ka rajoni. Në Rajonin e Shkupit, shqiptarët janë shumicë dhe udhëheqin me vetëm katër komuna nga shtatëmbëdhjetë sa ka rajoni: Çairi, Saraji, Studeniçani dhe Haraçina.






Figura 1

## 2.2 Diskriminimi i dytë: shpërndarja e padrejtë e dotacioneve në baza kombëtare

Për të konfirmuar apo jo karakterin diskriminues dhe shantazhues të sistemit të dotacioneve, është me rëndësi të krahasohen transferet drejt komunave duke marrë parasysh përbërjen kombëtare dhe përkatësinë partiake të tyre, si në nivel shteti ashtu edhe përbrenda rajoneve planore.

Në nivel shteti, e vetmja komunë shqiptare që figuron në kuartilin e parë (20 nga gjithsej 80) të komunave më të financuara përmes dotacioneve është Dollneni, i cili radhitet i trembëdhjeti me 180 euro për kokë banori. Kuartilin e parë i prinë Shën Nikolla me 406 euro për kokë banori, ndërsa Strumica e mbyll atë me 170 euro për kokë banori (figura 2).

## 20 KOMUNAT E PARA SIPAS DOTACIONEVE PËR KOKË BANORI




Figura 2

Tetë komuna shqiptare gjinden në kuartilin e fundit të komunave më të nënfinancuara : Çairi, Vrapçishta, Haraçina, Saraji, Zhelina, Studeniçani, Bogovina, Tearca (figura 3).

## 20 KOMUNAT E FUNDIT SIPAS DOTACIONEVE PËR KOKË BANORI




Figura 3

Komunat e vetme shqiptare që nuk janë pjesë e kuartilin të fundit janë Dollneni (kuartili i parë) Tetova, Dibra (kuartili i dytë), Struga, Kërçova, Likova dhe Gostivari (kuartili i tretë).

**Pra, nga 15 komuna me shumicë shqiptare, tetë apo 53% gjinden në kuartilin e fundit; 4 apo 27% në kuartilin e tretë; 2 apo 13% në kuartilin e dytë; 1 apo 7% në kuartilin e parë. Gostivari është e vetmja komunë e udhëhequr nga opozita shqiptare e cila nuk gjindet në kuartilin e fundit.**

### **Komunat shqiptare përbrenda rajoneve planore: të nënfinancuara në krahasim me ato maqedone**

Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë 2021, shqiptarët janë shumicë apo komuniteti i parë në 18 komuna: Bërvenica, Bogovina, Çairi, Çashka, Dibra, Dollneni, Gostivari, Haraçina, Jegunoci, Kërçova, Likova, Saraji, Struga, Studeniçani, Tearca, Tetova, Vrapçishta, Zhelina.

Bërvenica, Çashka dhe Jegunovca udhëhiqen nga partitë maqedone dhe nuk janë përfshirë ndër komunat shqiptare në kuadër të këtij studimi. Haraçina në anën tjetër, në vitin 2020 udhëhiqej nga SDSM por që në kuadër të këtij studimi është futur te komunat shqiptare meqë udhëheqja e komunës ishte shqiptare.

**Nga përpunimi i numrave, del se komunat shqiptare janë përgjithësisht të nënfinancuara krahasuar me ato me maqedone.**

Në rajonin e Shkupit, asnjë komunë shqiptare nuk është ndër 5 komunat më të financuara përmes dotacioneve. Çairi zë vendin e shtatë nga gjithshej 17 komuna sa ka rajoni, me 110 euro për kokë banori, ndërsa komunat rurale shqiptare janë thellësisht të nënfinancuara: Haraçina zë vendin e dhjetë me 100 euro, Saraji vendin e dymbëdhjetë me 97 euro dhe Studeniçani vendin e trembëthjetë me 96 euro për kokë banori. Komuna më e financuar brenda rajonit është Sopsishti, një komunë me shumicë maqedone fqinje e Studeniçanit, me 217 euro për kokë banori, pra mbi dyfishi i Çairit, si komuna me shumicë shqiptare më e financuar brenda rajonit (figura 4).

## SHKUPI




Figura 4

Në Pollog, ndër tre komunat me dotacionet më të larta për kokë banori, dy janë me shumicë maqedone, respektivisht Mavrova dhe Rostusha me 183 euro për kokë banori dhe Jegunovci me 120 euro. Tetova radhitet e dyta me 161 euro (figura 5).

## POLLOGU




Figura 5

Në rajonin verilindor, Likova, një ndër komunat më të varfëra rurale në vend, radhitet e parafundit me 122 euro për kokë banori. E para është Kratova, me 195 euro, apo 59,8% më tepër investime se sa Likova (figura 6).




Figura 6

Në rajonin jugperëndimor, komunat më të nënfinancuara janë Kërçova dhe Struga me 129 dhe 131 euro për kokë banori respektivisht. Dibra radhitet e treta brenda rajonit me 161 euro për kokë banori (figura 7).

## JUGPERËNDIMOR




Figura 7

Në rajonin e Pellagonisë, Dollneni radhitet i dyti me 180 euro për kokë banori, prapa Novacës me 196 euro (figura 8). Komuna e Dollnenit udhëhiqet nga BDI dhe shqiptarët janë komuniteti më i madh me 35,7% të populates.

## PELLAGONIA




Figura 8

**Në nivel të përgjithshëm, top treshja e komunave më të financuara brenda secilit rajon planor përbëhet nga komuna me shumicë maqedone, me përjashtim të Tetovës në Pollog (e dyta), Dibrës në rajonin jugperëndimor (e treta), dhe Dollnenit në Pellagoni (i dyti). Të trija këto komuna udhëhiqen BDI e cila është pjese e pushtetit qendror dhe asnjë nga opozita shqiptare.**

## **Komunat shqiptare të nënfinancuara edhe në bazë të indikatorëve socio-ekonomik**

Trendi i favorizimit të komunave maqedone dhe e diskriminimit të atyre shqiptare konfirmohet edhe nga analiza krahasuese sipas indikatorëve socio-ekonomik.

**Përgjithësisht, komunat shqiptare janë thellësisht të nënfinancuara, rrjedhimisht të diskriminuara, krahasuar me ato maqedone që ndajnë karakteristika të ngjashme socio-ekonomike, siç janë numri i përgjithshëm i popullatës dhe ndarja urbane-rurale.**

Kështu, Haraçina përfiton dotacione prej 100 euro për kokë banori, dukshëm më pak se komuna maqedone me karakteristika të ngjashme socio-ekonomike siç janë Probishtipi (167 euro për kokë banori) dhe Dellçeva (166 euro për kokë banori). Pra, Haraçina është respektivisht 67% dhe 66% më pak e financuar sesa Probishtipi dhe Dellçeva (figura 9).

Sipas së njëjtës logjikë:

- Tearca është respektivisht 93% dhe 91% më pak e financuar sesa Gjevgjelia dhe Radovishi (figura 10).
- Studeniçani është respektivisht 59% dhe 57% më pak i financuar sesa Gjevgjelia dhe Radovishi (figura 11).
- Zhelina është respektivisht 56% dhe 58% më pak e financuar sesa Radovishi dhe Koçani (figura 12).
- Bogovina është respektivisht 82% dhe 84% më pak e financuar sesa Radovishi dhe Koçani (figura 13).
- Vrapçishta është respektivisht 48% dhe 50% më pak e financuar sesa Radovishi dhe Koçani (figura 14).
- Likova është respektivisht 24% dhe 25% më pak e financuar sesa Radovishi dhe Koçani (figura 15).
- Saraji është respektivisht 87% dhe 64% më pak i financuar sesa Kavadarci dhe Shtipi (figura 16).

- Kërçova është respektivisht 3% dhe 27% më pak e financuar sesa Ohri dhe Prilepi (figura 17).
- Gostivari është respektivisht 25% dhe 30% më pak i financuar sesa Manastiri dhe Kumanova (figura 18).
- Struga është respektivisht 1,5% dhe 10% më pak e financuar sesa Ohri dhe Prilepi (figura 19).




Figura 9




Figura 10




Figura 11




Figura 12




Figura 13




Figura 14






Figura 14




Figura 15




Figura 16




Figura 17




Figura 19

## Vetëm katër komuna shqiptare bëjnë përjashtim sa i përket diskriminimit që u bëhet komunave shqiptare në aspektin socio-ekonomik.

Dibra është e financuar në nivel të njëjtte që ndanë karakteristika socio-ekonomike të ngjashme me Kriva Pallankën dhe Gjevgjelinë, me 161 euro dotacione për kokë banori, financohet në nivel të njëjtte me Kriva Pallanka (161 euro) dhe 5% më shumë se dyta Gjevgjelia (153 euro për kokë banori) (figura 20).

Tre komunat tjera shqiptare që qëndrojnë mirë krahasuar me ato maqedone janë:

- Dollneni i cili është 8% më i financuar se Probishtipi dhe Dellçeva (figura 21).
- Çairi është respektivisht 8% dhe 10% më i financuar se Karposhi dhe Gazi Baba (figura 22).
- Tetova është respektivisht 9% dhe 5% më e financuar se Manastiri dhe Kumanova (figura 23).




Figura 20




Figura 21




Figura 22




Figura 23

## 2.3 Diskriminimi i tretë: shpërndarja e padrejtë politike

Për fund, është e rëndësishme të krahasohen komunat shqiptare mes vete, si në vlerë absolute ashtu edhe në vlerë për kokë banori të dotacioneve, për të nxjerrë mësim rreth diskriminimit të mundshëm të komunave opozitare nga pushteti qendror.

Radhitja e komunave shqiptare sipas dotacioneve në vlerë absolute tregon se pesë përfitueset më të mëdha janë qendrat e mëdha urbane. Tetova i prinë dukshëm listës me 16,9 milionë euro transfere nga dotacionet, e pasuar nga Gostivari me 11,1 milionë, Struga me 9,2 milionë, Çairi me 7,6 milionë dhe Kërçova me 7,3 milionë euro (figura 24).

Këto 5 komuna marrin bashkë 52 milionë euro nga gjithsej 80,3 milionë euro sa marrin 15 komunat shqiptare së bashku, apo 64,8% e shumës së përgjithshme. Komunat e udhëhequra nga opozita (4), përveç Gostivarit, janë që të gjitha në pjesën e dytë të tabelës, gjë që tregon për një lloj shantazhi që u bëhet komunave opozitare nga pushteti qendror.




Figura 24

Shantazhimi i komunave opozitare konfirmohet edhe më tej përmes radhitjes së komunave shqiptare sipas dotacioneve për kokë banori.

Kështu, Dollneni i prinë listës me 180 euro për kokë banori, por është komuna e vetme e udhëhequr nga një parti shqiptare ku shqiptarët nuk janë shumicë.

Në këtë rrafsh, komuna e parë e udhëhequr nga opozita është Gostivari, por që sipas kriterit për kokë banori bie në vendin e shtatë të listës, me 118 euro për kokë banori. Katër komunat tjera të udhëhequra nga opozita janë që të gjitha në pjesën e dytë të tabelës, e cila përbëhet nga komuna rurale (figura 25).




Figura 24

# KONKLUZION: DOMOSDOJA E RRITJES SË AUTONOMISË FISKALE TË KOMUNAVE

Diskriminimi multidimensional me të cilin përballen komunat shqiptare mund të adresohet vetëm përmes rritjes së autonomisë fiskale të komunave përmes një decentralizimit të mirëfilltë fiskal, kusht ky i përsëritur në vazhdimësi edhe nga Bashkimi Evropian në raportet e progresit për Maqedoninë e Veriut.

Në nivel të qeverisjes komunale, kjo mund të arrihet përmes rritjes së llogaridhënies së autoriteteve lokale, për një shfrytëzim më të mirë të tatimeve dhe taksave ekzistuese lokale, rritjes së inkasimit të tatimeve dhe taksave komunale, si dhe vendosjes së instrumenteve shtesë të tatimeve lokale.

Veç kësaj, reformimi i metodologjive për rishpërndarjen e të ardhurave nga tatimi personal dhe TVSH-ja mund të kontribuojnë në uljen e pabarazive sa i përket kapaciteteve të komunave për të përmbushur detyrimet e tyre.

Për një decentralizim fiskal funksional, nevojitet që të ardhurat e komunave nga 15,7% sa janë tani, të arrijnë në 30% të të ardhurave të përgjithshme publike, duke mundësuar autonomi fiskale të qëndrueshme për vetëqeverisjen lokale.

Për arritjen e këtij synimi, Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi propozon një sërë masash dhe iniciativa në kuadër të reformës së mëtejme të financimit të vetëqeverisjes lokale.

- 1. Decentralizimi funksional.** Decentralizimi aktual institucional është bazë për krijimin e pabarazisë në të ardhura për kokë banori. Ky model decentralizimi e lidhë bartjen e kompetencave me ekzistimin e institucioneve në sektorë përkatës. Për shkak të dezinvestimit historik në rajonet shqiptare, komunat shqiptare ballafaqohen me mungesë të institucioneve gjegjëse. Kjo pamundëson alokimin e mjeteve nga dotacionet qeveritare në nivelin lokal, që është një model i padrejtë dhe burim diskriminimi. Kalimi në modelin funksional ku subvencionet janë të përgjithshme dhe synojnë rritjen e kapacitetit të komunave për të përmbushur misionin e tyre ligjor, mundëson financimin e nevojave të qytetarëve dhe jo të objekteve.

- 2. Fondi komunal.** Krijimi i fondit komunal, i bazuar në përvojat evropiane, do të mundësonte dotacione të përgjithshme, pa asnjë alokim drejt ndonjë misioni apo projekti specifik. Qëllimi kryesor është që t'u mundësohet komunave të përmbushin mandatin e tyre të përgjithshëm sipas kompetencave të tyre. Ky fond do të mund të financohej përmes ndryshimit të formulës për shpërndarjen e TVSH-së dhe rritjes së përqindjes së TVSH-së që u kthehet komunave nga 4,5% në 10%.
- 3. Miratimi i një plani për revitalizimin e vendbanimeve.** Me këtë iniciativë do të hartohej edhe një program i investimeve publike për nevojat elementare jetësore, si ujë për pije, kanalizim, asfaltim dhe ndriçim të vendbanimeve.
- 4. Krijimi i një institucioni financiar publik për kreditimin e komunave me kushte të volitshme (norma e interesit 1%),** që do të shërbente si burim i financimit të komunave dhe si mbikëqyrës i financave komunale, bazuar në përvojat evropiane. Huamarrjet e komunave do të ishin të mundura vetëm për investime kapitale lokale.
- 5. Rritja e kompetencave të komunave në menaxhimin e pasurive natyrore,** si uji, pyjet dhe minierat, me një ndarje të të ardhurave ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal në raport 80/20.

Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi  
E-mail: [info@ipp-arbenxhaferi.org](mailto:info@ipp-arbenxhaferi.org)  
Tel: +389 2 522 2922  
Web: [www.ipp-arbenxhaferi.org](http://www.ipp-arbenxhaferi.org)  
Rruga Dame Gruev 7/8/3  
1000 Shkup  
Maqedonia e Veriut

**Rishikimi i dotacioneve komunale:  
Reforma e domosdoshme e decentralizimit fiskal**

Tetor 2022

